**ACTIVE MOBILITY**

1. **Informacion Bazë**

- Viti i Themelimit: 2023
- Statusi Ligjor: OJF (Qendër)
- Selia Qendrore: Rruga Sami Frashëri, nr.3, Tirane, Shqipëri
- Faqja e Internetit: www.activemobility.al
- Email kryesor i organizatës: activemobilityalbania@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: +355 68 274 8148

**2. Misioni**
Të promovojmë kulturën e biçikletës në Shqipëri duke rritur ndërgjegjësimin për sigurinë rrugore dhe duke zhvilluar infrastrukturë të qëndrueshme për të gjithë, me theks te përfshirja gjinore dhe qasja për grupet vulnerabël.

3. **Vizioni** (Opsionale)

Një Shqipëri më e gjelbër dhe gjithëpërfshirëse, ku çdo person ka akses dhe mundësi të përdorë transportin e qëndrueshëm për një komunitet dhe planet më të shëndetshëm.

**4. Fushat Kryesore të Fokusit**
Një listë ose përshkrim i shkurtër i sektorëve ose fushave kryesore të punës së organizatës. Për shembull:

- Mbrojtja e Mjedisit
- Zhvillimi i Komunitetit
- Promovimi i Mobilitetit të Qëndrueshëm
- Edukimi dhe Ndërgjegjësimi për Sigurinë Rrugore
- Advokimi për Politika të Qëndrueshme dhe Infrastrukture Biçikletash
- Përfshirja Gjinore dhe Barazia Sociale

**5. Aktivitetet/Programet Kryesore**
Një përshkrim i shkurtër i projekteve, nismave ose programeve kryesore që organizata zhvillon ose ka zhvilluar:

- Projekti/Programi 1: Green Trail / Shtegu i Gjelbër
  Një garë biçikletash *off-road* në fshatrat turistike rreth Tiranës, me qëllim promovimin e turizmit të qëndrueshëm dhe ndërgjegjësimin për menaxhimin e mbetjeve gjatë garës. Përfitues janë komunitetet lokale dhe turistët.
- Projekti/Programi 2: Bike Fest Tirana
  Festë vjetore për Ditën Botërore të Biçikletës që përfshin aktivitete për fëmijë, panair biçikletash dhe fushata ndërgjegjësimi për sigurinë rrugore. Përfshin qytetarë të të gjitha moshave dhe komunitetin e çiklistëve në Tiranë.

**ACTIVE MOBILITY**

- Projekti/Programi 3: EduMove – Zhvillimi i Mobilitetit të Gjelbër në Periferinë e Tiranës
  Një program për promovimin e biçikletave dhe ecjes si mënyra të qëndrueshme të transportit në zonat periferiale të Tiranës, duke përmirësuar infrastrukturën dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël.

- Projekti/Programi 4: The Future of Cycling Conference
  Organizim i një konference ndërkombëtare që mblodhi akademikë dhe aktivist për të diskutuar zhvillimet e ardhshme në fushën e biçikletave, turizmit me biçikleta, ndikimin në shëndet dhe qasjet inovative në mobilitetin urban.

- Projekti/Programi 5: The Potential of Cargo Bikes to Transform Last Mile Delivery in Tirana
  Konferencë dhe diskutime mbi përdorimin e biçikletave me ngarkesë si zgjidhje për transportin urban dhe uljen e ndotjes dhe trafikut në Tiranë.

**6. Shtrirja Gjeografike**

Active Mobility operon kryesisht në Shqipëri, me fokus kryesor në qytetin e Tiranës dhe zonat përreth tij. Gjithashtu, organizata ka bashkëpunime dhe aktivitete të lidhura me komunitetet në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë iniciativa dhe projekte të përbashkëta me partnerë në Kosovë.

**7. Udhëheqja**
Drejtori Ekzekutiv/CEO: Enea Halili (inxhinier)
Bordi i Drejtuesve: Flavia Comashi (urbaniste), Sindi Hajdaraj (juriste) dhe Alba Cala (arkitekte, urbaniste)

**8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet** (Opsionale)

- **European Cyclists' Federation (ECF)** – anëtar i asociuar në organizatën më të madhe të mobilitetit të qëndrueshëm në Europë.
- **Ana Lindh Foundation** – anëtar aktiv në rrjetin për dialog kulturor ndërkombëtar.
- **OTTER EU** – rrjeti për mësimin jashtë klasës.
- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** – financues i projektit "Green Trail / Shtegu i Gjelbër."
- **Bashkia Tiranë** – mbështetje për "Bike Fest Tirana" dhe iniciativa të tjera sportive dhe të mobilitetit.
- **Ambasada Holandeze në Tiranë** – mbështetje për Javën Evropiane të Mobilitetit.
- **European Science Foundation (BE)** – financues i projektit EduMove për mobilitetin e gjelbër në periferinë e Tiranës.
- **Western Balkans Fund (WBF)** – mbështetje për bashkëpunimin rajonal në turizmin me biçikleta dhe formate të tjera.

**ACTIVE MOBILITY**

- **Central European Initiative (CEI)** – financues i konferencave dhe projekteve mbi të ardhmen e biçikletes dhe ngarkesave me biçikleta.
- **Ambasada Australiane** – financim për projekte përfshirjeje dhe trajnimi në komunitete vulnerabël si komunitetet Roma dhe Egjiptiane.
- **MEKI** – financim për ekspozitën e pare historike te përdorimit te biçikletës.

Gjithashtu, Active Mobility bashkëpunon ngushtë me organizata rajonale dhe lokale, përfshirë **Center for Competitive Skills (CCS)** në Tiranë për ekspertizë në zhvillim të qëndrueshëm.

**9. Ndikimi** (Opsionale)
Theksoni ndonjë rezultat të matshëm, statistika, ose arritje të rëndësishme. Për shembull:

• Janë ofruar mbi **50 trajtime/kurse praktike** të sigurisë rrugore dhe përdorimit të biçikletës në shkolla dhe komunitete.
• Më shumë se **400 biçikleta janë dhuruar** direkt tek fëmijët në zonat periferike të Tiranës për të inkurajuar mobilitetin aktiv.
• Rreth **600 gra dhe fëmijë** kanë marrë pjesë në trajnimet e biçikletës dhe kurset për sigurinë rrugore.
• Janë kryer mbi **150 riparime dhe mirëmbajtje biçikletash** në bashkëpunim me bashkite lokale.
• Janë organizuar të paktën **10 workshop-e dhe Cyclist Talks**, duke përfshirë temat për sigurinë, infrastrukturën dhe përfshirjen gjinore.
• Në aktivitetet tona kanë marrë pjesë mbi **10,000 pjesëmarrës** gjatë viteve të fundit përmes eventeve si Bike Fest Tirana dhe fushatave të ndërgjegjësimit.

**10. Lajmet e Fundit/Çmimet** (Opsionale)

Paraqesim punën tone shume shpesh ne mediat lokale por edhe ndërkombëtare, dy intervistat me te fundit janë këto:

- ***https://accting.eu/from-hand-me-down-bikes-to-a-city-wide-shift/* (Accting, interviste Maj 2025)**
- ***https://www.youtube.com/watch?v=0B8ldsMlW08&t=1s* (Report TV per ekspozitën e biçikletës, Maj 2025)**